

STRUKTURA ORGANIZATIVE/ORGANIGRAMA

Urdhri nr. 3, datë 12.01.2023 i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit të Aviacionit Civil”.

Struktura dhe organika e Autoritetit miratohet me urdhër të Kryeministri, me propozim e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Organet Drejtuese të AAC-së janë:

- a. Këshilli Drejtues (KD)
- b. Drejtori Ekzekutiv (DE)

Këshilli Drejtues është organi vendimmarrës i AAC-së dhe përbëhet nga 1 kryetar dhe 4 anëtarë, të cilër emërohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Drejtori Ekzekutiv (DE)

DE është titullari më i lartë ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil i cili drejton dhe administron të gjithë veprimtarinë e Autoritetit dhe përfaqëson autoritetin në marrëdhëniet me të tretët. Ushtron të gjitha të drejtat dhe detyrat për të siguruar plotësimin e detyrimeve, që i janë ngarkuar Autoritetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe nënshkruan të gjitha autorizimet, lejet, licensat e kategorizimet. Miraton manuale dhe procedura me karakter tekniko-operacional.

Drejtori Ekzekutiv emërohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kabineti:

- a. Drejtor Kabineti
- b. Këshilltarët e kabinetit
- c. Asistente e DE

Struktura Organizative

Për kryerjen e aktivitetit të saj, struktura e AAC-së është e ndërtuar/organizuar nga 8 drejtori, të cilat ndërveprojnë midis tyre për të promovuar zhvillimin e aviacionit civil, mbikëqyrjen e sigurisë në operim dhe sigurisë në aviacion, pa lënë menjatë çështje të mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes së të drejtave të pasagjerëve, ofrimit të shërbimeve cilësore si dhe konkurrencës së ndershme.

Koordinator Antikorrupsion:

- a. Koordinator i antikorrupsionit

Drejtorita e Standardeve të Fluturimit (DFS):

DFS ka si objekt pune të garantojë sigurinë në operime (safety) të avionëve, pasagjerëve dhe ekuipazhit të fluturimit nëpërmjet, regjistrimit të avionit, vlefshmërisë ajrore, certifikimin e operatorit ajror dhe mbikëqyrjes së operimeve, inspektime etj.

DFS drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë dhe ka në përbërjen e saj sektorët:

- a. Sektori i Vlefshmërisë Ajrore
- b. Sektori i Operimeve në Fluturim
- c. Sektori i Avionëve pa Pilot

Drejtoria e Navigimit Ajror (DAN):

DAN ka si objekt pune menaxhimin, verifikimin e përputhshmërisë së standardeve dhe kërkesave për ofruesit dhe përdoruesit e shërbimeve të navigimit ajror.

DAN drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë dhe ka në përbërjen e saj sektorët:

- a. Sektori i Menaxhimit të Trafikut Ajror
- b. Sektori i Komunikimit, Navigimit & Survejimit

Drejtoria e Aerodromeve (DAD):

DAD ka si objekt pune ofrimin e një mjedisi të sigurtë operacional, certifikimin e aerodromeve dhe auditimi i sigurtë në operim.

DAD drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Aerodromeve dhe ka në përbërjen e saj sektorët:

- a. Sektori i Standardeve të Aerodromeve
- b. Sektori i Infrastrukturës

Drejtoria e Sigurtë në Aviacion (DAS):

DAS ka si objekt pune garantimin e sigurtë në aviacionit civil nëpërmjet zbatimit të politikave dhe planifikimeve të çështjeve të sigurtë në nivel kombëtar, me qëllim parandalimin e akteve të ndërhyrjes së paligjshme.

DAS drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Sigurtë në Aviacion dhe ka në përbërjen e saj sektorët:

- a. Sektori i Certifikimit dhe Mbikëqyrjes së Shërbimit
- b. Sektori i Mbikëqyrjes së Personelit dhe Pajisjeve

Drejtoria e Trajnimeve dhe Licensimit (DTL):

DTL ka për qëllim rritjen e efikasitetit të trajnimit. Centralizon të gjithë procesin e organizatave të trajnimeve për të menaxhuar më mirë të dhënat e procesit të licensimit. Funksionet e DTL janë të ndërlidhura ngushtë me drejtoritë teknike të AAC.

DTL drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Trajnimit dhe Licensimit dhe ka në përbërjen e saj sektorët e mëposhtëm:

- a. Sektori i Trajnimeve
- b. Sektori i Licensimit të Personelit

Drejtoria e Legjislacionit dhe Sigurisë në Operime (DLS):

DLS ka si objekt pune përafrimin e legjislacionit, marrëveshjet mbi shërbimet ajrore dhe çështjet ligjore të të drejtave të pasagjerit, ku përfshihen sektorët e mëposhtëm :

DLS drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Legjislacionit dhe Sigurisë në Operime dhe ka në përbërjen e saj sektorët:

- a. Sektori i Legjislacionit në Aviacion
- b. Sektori i Cilësisë, Sigurisë në Operime dhe Përputhshmëri

Drejtoria e Rregullimit Ekonomik (DER):

DER ka si objekt pune të garantojë dhe zhvillojë shërbimin ajror sipas kuadrit ligjor, rregullator i standardeve të përcaktuara, nëpërmjet sigurimit të qëndrueshmërisë financiare të ofruesit të shërbimeve ajrore, licensimit të operatorëve ajrorë dhe mbrojtjen e të drejtave të pasagjerit.

DER drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Rregullimit Ekonomik dhe ka në përbërje të saj sektorët.

- a. Sektori i Lejeve dhe Operimeve
- b. Sektori i të Drejtave të Pasagjerit
- c. Sektori i Mbikëqyrjes Ekonomike dhe Statistikave

Drejtoria e Administratës (DAM):

DAM ka si objekt pune kryerjen e të gjitha funksionet mbështetëse për mbarëvajtjen e punës së institucionit, si dhe krijimin e kushteve dhe të një mjedisi të përshtatshëm për punonjësit.

DAM drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Administratës dhe ka në përbërjen e saj sektorët.

- a. Sektori i Financës dhe Buxhetit
- b. Sektori i Prokurimeve
- c. Sektori i Burimeve Njerëzore
- d. Sektori Ligjor
- e. Sektori i Shërbimeve Mbështetëse